

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -III- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 29 MARS 2018

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:15.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri: Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakte Dushi, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Fjolla Ujkani, Gentiana Rama, Gresa Muli, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Lorik Maxhuni, Lutfi Bilalli, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifi, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Qerim Selimi, Rrezarta Krasniqi, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Sami Istrefi, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës - z.Xhafer Tahiri, nënkryetari i komunës - z.Besim Muzaqi, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se ka shumicë për punë dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Nasuf Aliu, kryesues i Kuvendit –pasi falënderoi të pranishmit, shpалosi rendin e ditës duke paraqitur edhe disa pika shtesë në pikën në të ndryshme.

Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit - lexoi në deklaratë para anëtarëve të kuvendit të cilën në tërësi e gjeni në vijim: pasi falënderoi bashkë partiakët e saj deklaroi se tani e tutje nuk i përket grupit kuvendar të PDK-së dhe se nuk i bashkohet asnjë subjekti tjetër politik në kuadër të kuvendit të komunës, kështu që nga sot do të jetë anëtare e pavarur e kuvendit të komunës. Në vazhdim ajo falënderoi bashkëpartiakët e saj për punët dhe angazhimet e gjertanishme në subjektin e përbashkët politik dhe dëshiron që të mos keqkuptohet nga ata, sepse qëndrimet dhe bindjet e saj janë më të rëndësishme sesa edhe komoditeti brenda një subjekti. Ajo mbetet e njëjta besnike ndaj vetvetes dhe gjithë qytetarëve të komunës sonë. E gjithë energjia e saj do të fokusohet në punën e saj si mjeke. Pastaj deklaroi se vota e saj do të shkojë aty ku duhet me dijen dhe kapacitetin që posedon. Në fund premtoi se do të jetë gjithherë bashkëpunuese për çdo gjë që do të varet nga ajo, për të mirën e qytetarëve të komunës sonë.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se në mbledhjen e kaluar kryetari i LDK-së dega në Vushtri z.Hysni Gërguri ka ngritur akuza të pabazuara kundër tij, duke thënë se unë jam ndodhur në konflikt të interesit për një donacion për çerdhen e fëmijëve dhe këtë akuzë e ka thënë dhe e ka bazuar në raportin e auditorit, për këtë ai ka reaguar pasi që kjo akuzë është e pavërtetë dhe jemi dakorduar që sot në këtë seancë që deputeti Hysni të prezantojë raportin dhe konstatimin e cituar nga i njëjti në të kundërtën të kërkojë falje publike për akuzën e pabazë, por nëse dëshmon atë që ka thënë, gjithashtu edhe ai

është i gatshëm të kërkojë falje publike, andaj pres të reflektojë deputeti në fjalë. Konsideron se kemi nevojë çdoherë të japim vërejtjet tona dhe të kërkojmë llogaridhënie dhe transparencë nga kryetari i komunës për çdo cent të qytetarëve që shpenzohet andaj unë kam bërë një parallogaritje të shpenzimeve, gjegjësisht të shpenzimeve për të cilat kryetari kur ka vendos të kandidojë për kryetar komune kurrë nuk ka thënë se do t'i shpenzojë bëhet fjalë për një vlerë shumë të lartë të mjeteve sipas përlllogarisë e që për mandatin 4 vjeçar kap vlerën prej 121.425,00€, duke llogaritur shpenzimet e derivateve, mirëmbajtjes dhe amortizimin e makinës sipas normave ligjore vjetore. Ju kryetar kur keni kandiduar për kryetar në formularin e dorëzuar në KQZ keni deklaruar se jetoni në fshatin Stanoc i Poshëm dhe në saje të kësaj deklarate jeni certifikuar, ju rikujtoj se deklarimi është zotim. Ju tani pa fije keqardhje mendoni të shpenzoni paranë e qytetarëve dhe të udhëtoni e jetoni në Prishtinë e të shpenzoni 121.425,00€ dhe të dëmtoni buxhetin e komunës në mënyrë jo të ligjshme dhe në kundërshtim me zotimet e juaja. Kryetar mos vazhdoni kështu kthehu në Vushtrri, ruaje paranë e qytetarit, eja dhe jeto me qytetarët e Vushtrrisë, kryetar nuk ka kuptim të shpenzosh shuma të majme të parasë së qytetareve për luksin e juaj, kryetar ju duhet të bashkëjetoni me qytetarët e Vushtrrisë, ju duhet ta ndani të mirën e të keqen me qytetarët e Vushtrrisë, ju duhet ta ndjeni mungesën e rrymës, mungesën e ujit njëjtë si qytetarët e Vushtrrisë. Kryetar ju duhet ta dini se në Komunën e Vushtrrisë kemi shumë familje në varfëri të skajshme, kemi gjithashtu shumë familje që jetojnë me asistencë sociale, ndërsa ju merrni pagën këtu nga taksat e qytetarëve andaj ju duhet që atë page ta harxhoni këtu, ju duhet që edhe tatimin në pronë ta paguani këtu, ju duhet njëjtë si të gjithë qytetarët e Vushtrrisë të merrni shërbimet shëndetësore këtu, ju duhet që fëmijët e tuaj t'i dërgoni në shkollat e Vushtrrisë njëjtë si të gjithë qytetarët e komunës, kryetar edhe në Vushtrri kemi bibliotekë ku mund të lexohet bile kemi tirazh të librave voluminoze sepse PDK-ja në qeverisjen 10 vjeçare ka punuar shumë për qytetarin, duhet ta dini dhe ju rikujtoj se në këtë periudhë ka realizuar 1711 projekte në vlerë financiare prej 110 milionë euro për qytetarin që i bie se çdo të dytën ditë ka dorëzuar një projekt në të mirë të qytetarit dhe për qytetarin andaj ju themi se nuk është e ndershme që thoni të kundërtën fundja 100 ditshi i kësaj qeverie po tregon se ju nuk jeni askund ama bash askund dhe do bindeni ju dhe qytetarët e Vushtrrisë çdo ditë që kam të drejtë. Vushtrria meriton të ketë një kryetar që bashkëjeton me ta, Vushtrria nuk duron të ketë një kryetar turist andaj mbetet të shohim do të jesh me qytetarët apo do vazhdosh si turist. Kryetar punët nuk po iu shkojnë mirë, keni ngecje të jashtëzakonshme në inicimin e procedurave të prokurimit edhe ato që i keni filluar po manifestohen me shkelje ligjore, anulim të aktiviteteve të prokurimit, njoftim për dhënie të kontratës pastaj anulim, ankesa në OSHP e shkelje tjera, duke filluar nga njësjia kërkuese e tutje. Kryetar ju po interferoni gati në të gjitha drejtoritë përkundër faktit se secili drejtor dhe drejtori ka kompetencat dhe përgjegjësitë e veta të qarta ligjore e me Statut të komunës sidomos në prokurim dhe po e marr një shembull në aktivitetin e prokurimit me titull Hartimi i projekteve, prokurimi ka pranuar 15 oferta nga operatorët ekonomikë si është e mundur që pa asnjë bazë ligjore të anulohet ky aktivitet i prokurimit dhe të mos ketë asnjë operator ekonomik të përgjegjshëm dhe pyes cilat janë arsyet e parashtrimit të kërkesave nga këta operatorë ekonomikë për rishqyrtim të ankesave. Edhe në mbledhjen e kaluar kam dhanë vërejtjet e mia rreth kriterëve diskriminuese dhe favorizuese për këtë aktivitet të prokurimit.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit- në adresimin e tij para kuvendit kërkoi të ndihmohet financiarisht botimi i një monografie dhe kjo është: “Pishtarët e arsimit shqip në Vushtrri dhe rrethinë “1915 – 2018”, vëllimi 3 dhe 4 i autorit profesor Ferit B. Dibrani. Kjo monografi është vazhdimësi e pjesës së parë dhe të dytë të botuar vitin e kaluar. Kjo monografi ka 1020 faqe tekst, si dhe dokumente, dëshmi e fotografi të cilat bëjnë fjalë për biografinë, jetën dhe punën e 573 pishtarëve të arsimit para fillor, fillor, të mesëm, të lartë dhe superior, të lindur në Vushtrri e rrethinë, por edhe ata të viseve tjera shqiptare, të cilët kanë punuar në komunën tonë. Gjithashtu në monografi janë përfshirë edhe arsimtarët e mësimi shqip në diasporë e nëpër vende të ndryshme perëndimore, për rëndësinë e kësaj monografie flet vet puna dhe angazhimi

i edukatorëve, mësuesve e mësimdhënësve, si dhe profesorëve të shkollave të larta e fakulteteve nga Vushtrria e rrethina për një periudhë mbi 103 vjeçare nga themelimi i shkollës së parë shqipe në Vushtri, më 1915 e deri në ditët e sotme. Përndryshe ky është libri i njëmbëdhjetë me radhë i Dibranit. Ai në librat e tij ka shkruar duke filluar nga masakrat ndaj shqiptarëve të viseve të Toplicës gjatë viteve 1987 dhe 1988, vendosjen e tyre në Maqedoni e Turqi, si dhe të një numri në shumë fshatra të Vushtrrisë, pastaj për shkollën e parë shqipe në Vushtri të vitit 1915, mbylljen e saj me gjak nga regjimi serb dhe helmimin e prefektit Efendi Izet Badivuku, masakrën e fshatit Zogaj apo Zagorit të vitit 1924, shpërnguljet me dhunë të shqiptarëve nga Vushtrria e rrethina për në Turqi nga viti 1913 e deri në vitin 1956, shkollat shqipe të viteve 1941 deri në vitin 1944, pushkatimet e shqiptarëve nga komunistët serbo – çetnikë gjatë viteve 1945 – 1946, pushkatimet e 21 fshatarëve të pafajshëm të fshatit Druar, mobilizimi i shqiptarëve me dhunë dhe vdekja e tyre nga uria e tifoja në Banatë e Srem, burgosjet e mësuesve shqiptarë pas pushtetit komunist, demonstratat e vitit 1968 dhe 1981 dhe burgosja e nxënësve, pjesëmarrës dhe organizues të tyre, diferencimin politikisht të arsimtarëve shqiptar nga viti 1981, të burgosurit politik, Lëvizjen e Pajtimit të Gjaqeve, periudhën për pavarësinë e Kosovës, mbijetesën e shkollës shqipe 1989 – 1999, ndihmën financiare për arsimin shqip nga popullata shqiptare brenda dhe jashtë vendit, si dhe pjesëmarrjen e arsimtarëve në luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, rënien heroike të anëtarëve të familjes Jashari në Prekaz dhe komandantit legjendar Adem Jashari, dëshmorët e lirisë, qëndresën heroike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Oshlan e Shalë të Bajgorës, vrasja e nxënësve dhe arsimtarëve shqiptarë, masakrat e policisë serbe në Martiraj e shtëpinë e Kahrman Pasomës në Vushtri, rrëfimet e të mbijetuarve nga këto masakra, djegien e shkollave dhe librave shqip etj. Mendoj se Kuvendi duhet ta përkrah botimin e kësaj monografie sepse pa ndihmën tonë autori si pensionist nuk do të mund ta botojë këtë monografi.

Nasuf Aliu, kryesues i Kuvendit – tha se lidhur me këtë pikë për financimin e monografisë duhet të analizohet aspekti ligjor dhe financiar i kërkesës, dhe nëse ka hapësirë jemi të gatshëm që t'i ndihmojmë hartuesit të kësaj monografie.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit - tha se kur flitet për interesat e qytetarëve, nuk duhet të ketë limite dhe as t'u ndërpritet fjala anëtarëve të kuvendit, në këtë rast ai e vazhdoi diskutimin e anëtarit të kuvendit z. Ilmi Azemi dhe shtoi: kryetar ju keni treguar performancë të mirë vetëm në menaxhimin e portaleve lokale të cilat i keni shndërruar në zëdhënës personal, sigurisht duke iu premtuar subvencione nga buxheti i komunës performancë të mirë ke tregu edhe në selfije në facebook, por kryetar menaxhimi i komunës nuk bëhet me facebook. Kryetar në mbledhjen e parë me karakter pune na keni prezantuar drejtorët e drejtorive ju pyes a janë të gjithë këta drejtorë- drejtorë real apo ka edhe fiktiv. Po konsideroj se do thoni real atëherë si është e mundur që në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe në kundërshtim me Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, por edhe me Statutin e komunës nuk keni autorizuar Drejtoreshën e Prokurimit Publik që të kryejë punët dhe detyrat sipas kompetencave dhe përgjegjësive të cilat në mënyrë takstative janë të përshkruara në nenin 82 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, kryetar me këtë në kontinuitet po shkëlmi ligjin dhe Statutin e komunës. Kryetar emërimi dhe shkarkimi i drejtorëve dhe stafit politik është e drejtë ekskluzive e kryetarit dhe ne kemi pasur mirëkuptim lidhur me dhënien e kompetencave dhe përgjegjësive që ligjërisht i takojnë drejtoreshës së prokurimit, por ne e dimë që drejtoresha nuk ka punuar kurrë në prokurim, gjithashtu e dimë qysh është regjistruar për t'u pajisur me certifikatë të prokurimit dhe e dimë se tani posedon certifikatën, shtrohet pyetja si është e mundur që edhe më tej në kundërshtim me ligjin dhe Statutin e komunës nuk i jepen kompetencat që i takojnë drejtoreshës të cilën vetë e keni emëruar, por këto punë dhe detyra kryhen nga stafi i shërbyesve civilë. Kryetar me këtë tempo dhe me këto kapacitete qeverisëse ju paralajmëroj se nuk do të keni sukses në realizimin e projeksioneve buxhetore dhe si rrjedhojë do të keni normën e realizimit buxhetor shumë të ulët, kurse me këtë do ta dëmtoni çdo qytetarë të Komunës së Vushtrrisë sepse mjetet e

parapara me projeksione buxhetore të pashpenzuara do të kthehen në buxhetin e Kosovës në vend që të investohen në zhvillim ekonomik, infrastrukturë, arsim, shëndetësi, administratë etj.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit - njoftoi kuvendin se gjatë muajit mars, gjegjësisht me datën 8 Mars për ditën e gruas, si anëtare të Kuvendit, kemi qenë të ftuara në një drekë pune nga Kryesuesi i Kuvendit dhe OSBE-ja. Në këtë takim kemi formuar Grupin Joformal të Grave dhe kemi zgjedhur edhe kryesinë e saj e cila përbëhet nga unë Gresa Muli kryetare e grupit, Habibe Gërxhaliu, nënkryetare dhe Teuta Aruqi Shartari sekretare. Menjëherë pas formimit të grupit kemi filluar të angazhohemi në bashkëpunim me organizatën IADK për dizajnimin e një projekti me të cilin kemi aplikuar për një grant që ofrohet nga organizata CDF. Presim përkrahje edhe nga ana juaj për të shtyrë sa më shumë çështje përpara së bashku.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - tha se pozicionimi i institucionit të kryetarit si institucion kyç në trekëndëshin, kryetar (ekzekutiv) - kuvend komunal (legjislativ) – qytetar (shoqëri civile). Andaj konstatimi themelor i LB-së është se roli i institucionit të kryetarit në sistemin e qeverisjes lokale në Republikën e Kosovës shtron nevojën për më shumë kontroll, baraspeshë dhe mbi të gjitha llogaridhënie të brendshme institucionale, si dhe kundrejt publikut. Për shkak të rolit shumë të fuqishëm të institucionit të kryetarit në njërin anë, dhe në anën tjetër rolit pasiv të Kuvendit Komunal, i kombinuar me apatinë qytetare rezulton me shfaqjen e një deficiti demokratik shumë shqetësues për zhvillimet e qeverisjes lokale tani, por besoj edhe në të ardhmen. Edhe një herë po ta përkujtoj çfarë thotë ligji sepse në mbledhjen e kaluar e keni dezinformuar opinionin duke thënë se fotografinë e presidentit e mbani në vendin e duhur në zyrën tënde. Ligji Nr. 03/L-132 për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës neni 20 Presidenti/ja i/e Republikës 1. Presidenti/ja i/e Republikës përfaqëson autoritetin më të lartë të shtetit në Kosovë, që është shprehje e unitetit të popullit. Ushtrimi i mandatit të tij shoqërohet gjatë gjithë periudhës nga një ceremonial i veçantë për të gjitha aspektet zyrtare dhe jozyrtare të jetës dhe aktivitetit të tij. 2. Në pritje të ndryshme dhe festa shtetërore të dhëna nga përfaqësitë diplomatike të akredituara në Kosovë, presidenti i republikës merr pjesë vetëm në rastet kur e konsideron tepër të arsyeshme dhe të rëndësishme prezencën e tij. Pjesëmarrja e presidentit sinjalizohet nga protokollin i shtetit. 3. Obligohen të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës që në mjediset e tyre ta vendosin fotografinë e presidentit. Përmasat minimale duhet të jenë 40 – 60 cm, ndërsa Rregullorja nr.19/2011 për Kriteret e Përzgjedhjes dhe Vendosjes së Fotografisë së Presidentit/es të Republikës së Kosovës neni 4 Forma e fotografisë 1. Fotografia duhet të ketë përmasat minimale 40-60cm. 2. Fotografia duhet të jetë e vendosur në kornizë. 3. Fotografia në zyrë duhet të vendoset në mur në vend të dukshëm/ballor. 4. Fotografia duhet të vendoset në distancë afërsisht 2 m nga dyshemeja, kurse neni 8 ku flitet për përgjegjësinë për zbatim thuhet që: përgjegjësinë për zbatimin e kësaj rregulloreje e kanë drejtuesit e të gjitha institucioneve shtetërore, si dhe përfaqësive tona diplomatike dhe konsullore jashtë vendit. Për moszbatimin e kësaj rregulloreje do të merren masa disiplinore dhe masa tjera ligjore.

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës - në adresimin e tij para anëtarëve të kuvendit, paraqiti një rezymë të përgjithshme lidhur me punët që kanë filluar dhe që presin të implementohen në të ardhmen, ku ndër të tjera shtoi se në rrafshin e zhvillimit ekonomik janë siguruar 1.200.000 € për zhvillimin e projektit të zonës ekonomike Parku i Biznesit në fshatin Lumadh, në këtë rast njoftoi se sot përfundimisht janë plotësuar të gjitha kërkesat konform udhëzimit administrativ të Ministrisë së Industrisë për licencim të zonës ekonomike përkundër faktit që ka pasur tendencë që në Ministrinë e Bujqësisë ta bllokojnë procesin dhe ka mbi dy muaj që kjo ministri e mbanë shkresën e komunës dhe nuk kthen përgjigje, por sot kemi informacion se kjo kërkesë është aprovuar, në ç'rast kemi pasur një vonesë të paarsyeshme nga ana e ministrisë por që tashmë është zgjidhur kjo çështje. Zona ekonomike është projekti më i madh ekonomik dhe i punësimit për Vushtrrinë në pesëdhjetë vitet e fundit dhe e hap perspektivën e zhvillimit ekonomik dhe të punësimit në Komunën e Vushtrrisë. Lidhur me këtë çështje ai i shprehu mirënjohje kuvendit të komunës që në vitin 2011 kishte marrë vendim për shpalljen e kësaj zone me interes për komunën. Lidhur me këtë çështje ai njoftoi se kemi interesim të investitorëve për t'u vendosur

në këtë zonë ekonomike dhe për të krijuar vende të punës dhe ky është një lajm i mirë për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë. Sa i përket fushës së arsimit vlerësoi se qeveria e re ka vendosur rend në lëmin e arsimit dhe kanë ndryshuar mënyrën e raportimit nga drejtorët e arsimit për të pasur kontroll më efikase dhe rritje të cilësisë në arsim, në këtë kontekst ka filluar depolitizimi i arsimit, është vazhduar mandati i drejtorëve aty ku DA ka vlerësuar se drejtori ka bërë punë të mira dhe janë ndryshuar drejtorët aty ku është gjetur se ka pasur keqmenaxhim siç është rasti me çerdhen e qytetit ku është zëvendësuar ushtruesi i detyrës. Në fushën e urbanizimit drejtori aktual i cili ka një përgatitje solide në botën e jashtme, ka pranuar një detyrë të rëndë edhe përkundër presioneve dhe shantazheve ka vendosur rend dhe rregull në këtë branshe, dhe mund të thuhet se përherë të parë është duke u zbatuar Ligji për ndërtim në Komunën e Vushtrrisë. Në këtë relacion ai njoftoi se në të kaluarën asnjë objekt kolektiv nuk ka pasur të projektuar dhe zbatuar elaburata të ngrohjes, për asnjë objekt kolektiv nuk janë bërë shpimet e tokës për të parë se ku po vendosen ato objekte dhe se për herë të parë është filluar që të zbatohen rregullat që i parasheh Ligji i ndërtimit, dikujt kjo po i pengon, por në këtë rast është vendosur rendi dhe rregulli dhe do të vazhdohet me vendosjen e rregullit në fushën e urbanizimit. Në vazhdim ai njoftoi kuvendin se nga qeverisja e kaluar në lëmin e urbanizimit kanë gjetur një pëlqim për ngritjen e një objekti për shkatërrimin e barnave në komunë, ndërkohë që një pëlqim i tillë ishte mohuar në pesë komuna të Republikës së Kosovës, kjo gjë kishte ndodhur më datë 27.10.2017 dhe për këtë nuk ishte njoftuar kuvendi asnjëherë. Kjo fabrikë është tepër e rrezikshme, mjafton që vetëm njëherë diçka të shkojë keq dhe në këtë rast çdo grua shtatzënë do të abortonte dhe kjo do të kishte pasoja të pariparueshme për shëndetin e qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë, andaj këtë pëlqim e kanë anuluar dhe në këtë rast është njoftuar ministria gjegjëse. Gjithashtu edhe në lëmin e shëndetësisë është vendosur rregulli, ku është hequr kufizimi sa i përket numrit të pacientëve për analiza laboratorike, është zbuluar se laboratorit ka aparaturë moderne e papërdorur në qese najloni ku me këtë rast është punuar me aparaturë të vjetër duke u anashkaluar kështu qytetari me një konflikt të pastër interesi që ka ekzistuar aty. Po ashtu komuna jonë është e vetmja në Republikën e Kosovës që ka ndaluar reklamacionet e kompanive farmaceutike nëpër shtëpitë e shëndetit në Vushtrri nëpër QKMF dhe në të gjitha AMF-të dhe kjo është një e arritur jo e vogël në ç'rast duhet të përgëzohet drejtori i këtij drejtorati. Lidhur me lëmin e kulturës, njoftoi se më datë 27.04.2017 ky kuvend në një përbërje tjetër ka dëgjuar projektin e prof. Egzon Bjaraktarit për qendrën e kulturës kjo provohet me anë të procesverbalit dhe ky projekt nuk ishte kundërshtuar nga kuvendi, pastaj është vendosur në dëgjim publik, është diskutuar në dëgjim publik me shoqërinë civile, ajo se çfarë ka ndodhur është se projekti i cili është tenderuar është tjetër projekt nga ai i cili është prezantuar në kuvend, dhe se për këtë çështje nuk kemi një vendim të kuvendit se si do të duket një projekt i tillë kaq me peshë për komunën tonë me një kosto financiare mjaft të lartë të mbuluar gjysma nga komuna dhe gjysma tjetër nga Ministria e Kulturës. Andaj lidhur me krejt këtë ceku se tani komuna ballafaqohet me një kontratë, ku objekti aktual i kësaj qendre ka tri kate, kurse projekti i cili është tenderuar nga pushteti i kaluar ka dy kate dhe krejt kjo tregon për konfuzitet dhe jo transparencë sa i përket ndërtimit të këtij projekti. Mandej shtoi se janë duke vendosur rend e rregull edhe në fushën e prokurimit publik, duke e rritur transparencën dhe komuna jonë është përzgjedhur për bashkëpunim me USAID-in në aspektin e rritjes së transparencës. Sa i përket tenderit për hartimin e projekteve njoftoi se vitin e kaluar komuna jonë ka hartuar 122.000.00 € për hartim të projekteve, lidhur me këtë është hapur oferta aktualisht dhe ajo shkon nga 34.000 € deri 50.000 €, dhe nëse komuna arrin që të kontraktojë, hartimi i projekteve do t'i kushtojë komunës shumë më lirë se sa ka kushtuar gjatë qeverisjes së kaluar, për faktin se është hequr korrupsioni nga ky projekt dhe do t'i heqim nga të gjitha projektet në vazhdim. Pastaj njoftoi se projekti për menaxhimin e mbeturinave është në rrugën e duhur dhe se shumë shpejt Komuna e Vushtrrisë do të fillojë të shtrijë projektin e mbledhjes së mbeturinave në çdo fushatë të komunës dhe në tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë dhe për këtë janë duke bashkëpunuar me GIZIN gjerman. Gjithashtu rregulli është vendosur edhe

në Drejtorinë e Inspektimeve dhe për këtë e përgëzoi drejtorin e kësaj drejtorie. Po ashtu u zotua se do t'u ofrojë mbështetje Grupit të grave deputete. Në fund lidhur me vendosjen e fotografisë së Presidentit të Republikës së Kosovës tha se ligji është mjaft i qartë, dhe se fotografia e presidentit gjendet në zyrën e kryetarit të komunës, dhe ajo është e formatit të njëjtë dhe vendin e njëjtë ashtu si ndodhet edhe në institucionet tjera duke përfshirë edhe Zyrën e Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Sami Istrefi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar çështjes së dhënies së një pëlqimi për veprimtarinë e një fabrike për asgjësimin e barnave vlerësoi se për këtë duhet apriori të njoftohemi me procedurat që duhet ndjekur për marrjen e pëlqimit e që çdo palë ka të drejt të shfrytëzojë të drejtat e veta për ushtrimin e një veprimtarie ekonomike e që në rastin në fjalë kemi të bëjmë me lëshimin e një pëlqimi për një depo për trajtimin e barnave e që nga pala është prezantuar se investim i cili mund të jetë donacion apo financim tjetër. Andaj lidhur me këtë ata e kanë shqyrtuar dhe për këtë kanë dhënë një pëlqim ku në të është bërë përshtkrimi i asaj zone se çfarë destinimi urbanistik ka, kjo është me rëndësi të bëhet e ditur para kuvendit dhe jo në forma tjera të bihet në lajthitje kuvendi. Në këtë kontekst ai njoftoi se kjo çështje ka qenë në procedurë në shkallën e dytë që në këtë rast është Ministria e Mjedisit, dhe posa të përfundohet atje është dashur të bëhet edhe vlerësimi i ndikimit në mjedis dhe pastaj të finalizohet ky projekt. Andaj në këtë rast shtoi se nuk është mirë që në forma tjera të tentohet t'i jepet konotacion tjetër kësaj çështjeje sepse mendon se askush ndaj dikujt nuk ka diçka personale lidhur me këtë çështje. Lidhur me ndërtimet ceku se po të pyetet ai nuk do të jetë i kënaqur për faktin se të gjithë e duan një qytet të planifikuar mirë, por duhet marr në konsideratë edhe faktin se komuna jonë ka dal nga lufta tërësisht e djegur dhe e njëjta në forma të ndryshme qytetarët kanë ndërtuar në pronat e tyre ashtu siç ata kanë menduar duke mos u respektuar kriteret urbanistike e që për fat të keq deri në vitin 2009 ku për herë të parë ishte aprovuar PZHU-ja, më pas në vitin 2011 Komuna e Vushtrrisë ishte bërë edhe me tri plane rregulluese urbane, të cilat më vonë u shfuqizuan dhe së fundi të gjithë e dinë lidhur me Planin Zhvillimor Komunal se çfarë vështirësish kishte pasur deri në aprovimin e tij, ku ky plan do të trajtonte aspektin urban të të gjithë territorit të komunës sonë. Tutje shtoi se në vitin 2015 kishte bërë thirrje dhe kjo është e plasuar edhe në faqen zyrtare të komunës që zyrat projektuese që gjenden në territorin e komunës të mos të aplikojnë në formë të deformuar kundër kriterëve dhe kështu organet e administratës të vihen në lajthitje. Në fund tha se për të gjitha vendimet dhe çështjet urbanistike është mirë të shqyrtohet e analizohet baza ligjore e më pas të verifikohen faktet para se të bëhen akuza të pabazuara dhe krijim të insinuatave që dëmtojnë raportet dhe prekin personalitetin e kujtdo qoftë.

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së - paraqiti sqarime lidhur me temat e ngritura në aspektin urban, si dhe dha përgjigje në pyetjet e anëtarëve të kuvendit, duke shtuar se lëshimi i pëlqimit për ndërtimin e objektit (depos), për trajtimin e barnave është përcjell me shkelje ligjore dhe për këtë është anuluar ky pëlqim. Lidhur me ndërtimet kolektive vlerësoi se shumica e projekteve janë dërguar pa elaborat të liftit, pa shpime gjeomekanike dhe pa projekt të ngrohjes.

Sami Istrefi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar parafolësit, ceku se nëse dikush gjen shkelje ligjore, atëherë kujt po i drejtoheni, por ato lëndë dërgoni tek organet kompetente te hetuesi dhe prokuroria dhe jo të flitet kështu. Sa i përket shpimeve mekanike pyeti se drejtoi aktual i urbanizmit dikur në rolin e arkitektit qysh i ka sjellë projektet. Lidhur me çështjen e pëlqimit për depon përsëriti se për këtë është dhënë një pëlqim paraprak lidhur me destinimin e pronës sipas planit urbanistik dhe për këtë çështje do të kishte procedim në ministrinë gjegjëse se a i plotëson kriteret tjera ligjore. Në fund kërkoi që të gjithë të jenë të kujdesshëm në deklarime.

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës - siguroi anëtarët e kuvendit dhe të gjithë ata që kanë punuar dhe punojnë në komunë se ai dhe askush nga menxhmenti komunal nuk ka kundër askujt diçka personale dhe vlerësoi se përtej funksioneve publike që mbajmë ne jemi njerëz, kemi raporte njerëzore sociale dhe miqësore dhe kjo duhet respektuar nga të gjithë. Tutje shtoi se e vërteta është se komuna jonë ka dal e shkatërruar nga lufta, dhe në këtë kontekst ka pasur

ndërtime e mbindërtime, por që kurrë nuk është vonë që të vendosen standarde në fushën e ndërtimit dhe kjo është filluar, andaj kjo duhet të përshëndetet sepse kjo nuk është vendosur kundër askujt, nuk është për ta akuzuar askënd, është për të thënë se kur ndërtohet një objekt është mirë se çfarë fortësie se sa shkallë të tërmetit mund t'i bëjë ballë ai objekt e të ngjashme.

Sami Istrefi, anëtar i kuvendit - duke diskutuar për rendin e ditës, paraqiti vërejtjet e tij, për disa pika për të cilat shprehu mospajtimin e tij për futje në rend të ditës pasi ato nuk janë përgatitur ashtu si duhet. Tutje shtoi se propozim-vendimit për bartjen e mjeteve financiare duhet t'i bashkëngjitet një tabelë e cila është bërë në saje të rishikimit të buxhetit komunal për vitin 2017, ku ka të bëjë me projektet ndërtimi i kanalizimeve në vlerë prej 130.000.00 me kod ekonomik 41415, asfaltimi i rrugës "Met Istrefi" në Maxhunaj kod ekonomik 45757, asfaltimi i rrugës në lagjen "Isalmi" në fshatin Taraxhë projekt dyvjeçar me kod ekonomik 45643, furnizim me gypa për ujërat e zeza, si dhe projekti ndërtimi me kubëza betoi i rrugës në oborrin e shkollës profesionale "Bahri Haxha". Andaj lidhur me këtë propozoi që këtij propozim-vendimi t'i bashkëngjitet kjo tabelë me projektet e cekura më lartë. Në vazhdim vlerësoi se pikat që propozohen nga ekzekutivi komunal duhet të hartohen në suaza ligjore dhe jo të kemi divergjenca, dhe që ato vendime të kthehen prapthi nga MAPL-ja si të kundërligjshme. Në këtë kontekst shtoi se vetëm dy pika të rendit të ditë janë hartuar ashtu si duhet dhe të cilat do të mund të procedohen më tutje. Në vazhdim ai propozoi që pikat e rendit të ditës me numër rendor 3, 4,6, 7 dhe 9 duhet të hiqen nga rendi i ditës pasi që ato nuk i plotësojnë standardet minimale ligjore dhe ato të hartimit dhe vlerësoi se të njëjtat duhet të kthen dhe të plotësohen e pastaj të procedohen për aprovim në kuvend. Në fund kërkoi që të gjitha pikat e kontestuara më lartë të kthehen tek hartuesi që të harmonizohen dhe që deri në ora 14:00 kuvendi të marrë një pauzë, dhe mandej t'i zhvillojë punimet në mbledhjen e vet plenare.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - tha se edhe në mbledhjen e kaluar kishte bërë vërejtje se në propozim-vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës, numrat e parcelave nuk kanë qenë të shkruar në mënyrë të drejtë, dhe kjo po përsëritet edhe në këtë mbledhje, pasi që numrat në propozimin e korrigjuar nuk korrespondojnë me kopjen e planit. Andaj kërkoi që parcelës kadastrale 263 t'i shënohet shkronja K, pasi që e njëjta gjendet në masën e komasacionit. Pastaj lidhur me propozim-vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës për Akademinë Policore, vlerësoi se prona ku ndodhet ky objekt është pronë e komunës dhe për këtë kërkohet vendimi i kuvendit që t'i jepet në shfrytëzim kjo pronë këtij institucioni, si dhe për këtë askush nuk është kundër, por këtu shtrohet një çështje tjetër se a duhet që komuna gjithmonë të japë pronë në shfrytëzim pa kompensim kur dihet fakti se shumë prona në territorin e komunës që ndodhen në pronësi të institucioneve qendrore (Ministria e Drejtësisë), nuk janë bartur në pronësi të komunës edhe përkundër nevojës së madhe që ka komuna për këto prona. Në fund tha se ligji lë hapësirë që pronat të këmben dhe këtë me anë të kërkesës mund ta bëjë komuna, andaj inkurajoi që kjo mundësi ligjore të shfrytëzohet.

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së - paraqiti sqarime lidhur me pikën e nëntë (9) të rendit të ditës, si dhe u përgjigj në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Lutfi Gërgurri, drejtor i DBF-së - paraqiti sqarime lidhur me projektet e aprovuara në kuadër të buxhetit për vitin 2018.

Në fund të diskutimeve jashtë dhe për rendin e ditës kuvendi me 33 vota "për" 1 votë "kundër" dhe 1 votë "abstenim" aprovoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 22.02.2018;
2. Shqyrtimi i dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja solemne e kuvendit të komunës i datës 06.03.2018;
3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2017;
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim me kompensim të vendgjuetive të përbashkëta;
5. Shqyrtimi i Draft-rregullores për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione personave juridikë-OJQ dhe ndihmë momentale personave fizikë (shqyrtimi i parë);
6. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të objekteve;
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës pa kompensim për Ministrinë e Punëve të Brendshme-Akademisë së Kosovës për Siguri Publike;
8. Shqyrtimi i Informatës lidhur me Punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2017;
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për korigjimin e vendimit të kuvendit të komunës Nr.52/18 i 22.02.2018;
10. Të ndryshme.
 - a). Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë lidhur me themelimin e Komitetit për Komunitete.
 - b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin e Vendimit me Nr.50/18 i datës 22.02.2018 për Bartjen e të Hyrave Vetanake nga viti 2017 në vitin 2018.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 22.02.2018

Bahrije Ademi Murati anëtare e kuvendit - kërkoi që bëhet përmirësimi i emrit të anëtarit të kuvendit Ymer Hardinaj në faqen 22 të procesverbalit.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë "unanime" aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 25.01.2018, me vërejtjen e paraqitura nga anëtarja e kuvendit.

2. Shqyrtimi i dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja solemne e kuvendit të komunës i datës 06.03.2018

Lutfi Bilalli, anëtar i kuvendit - tha se në mbledhjen solemne, e cila është mbajtur për nder të dhjetë vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, ishte vonuar dhe nuk kishte mundur të marrë pjesë në fillimin e saj dhe në këtë kontekst sqaroi se këtë nuk e kishte bërë për shkak të intonimit të himnit shtetëror të Kosovës, porse vonesa kishte ndodhur për arsye tjera.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë "unanime" aprovoi procesverbalin nga mbledhja e solemne e kuvendit, e datës 06.03.2018, me vërejtjen e paraqitura nga anëtari i kuvendit.

3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2017

Gresa Muli, anëtare e kuvendit - në adresimin e saj para kuvendit, parashtroi një pyetje qeverisjes së kaluar në këtë rast si përfaqësues të saj, grupit kuvendar të PDK-së. E kam analizuar materialin për zbatimin e planeve investive për vitin 2017 dhe tek shpenzimet për mallra dhe shërbime komunale, shpenzimi me kodin 14310 gjegjësisht “ Dreka zyrtare” nga viti 2016 që ka përfshirë shumën 13,711 € euro paska pasur ngritje në 29,881 euro. Desha të di unë dhe besoj edhe qytetarët, a është arsyeja e kësaj ngritjeje enorme sepse viti 2017 ka qenë vit zgjedhor e që kjo i bie që paratë e qytetarëve janë shfrytëzuar për fushata apo ka ndonjë faktor specifik që e arsyeton këtë ngritje?

Agron Perçuku, anëtar i kuvendit - shprehi shqetësim lidhur me këtë raport ku thuhet për vitin 2017 e në fakt në faqen 23 të këtij raporti periudha raportuese është 01.01.2017 deri 13.03.2018 a është ky një gabim teknik apo janë përfshirë edhe të dhënat deri më 13.03.2018 çka konsideroj që nuk është dashtë sepse kemi në shqyrtim një raport për një vit fiskal 01.01.2017 deri 31.12.2018, ku kërkoi sqarim për këtë çështje. Në faqe 5 te përmbledhja e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve edhe këtu kemi një gabim kur bëhen krahasimet në vend që të jetë viti paraprak (2016) kemi vitin 2015, a janë të dhënat krahasuese të këtyre shpenzimeve të 2015-ës apo 2016-ës si është dashtë të jenë. Po në këtë faqe (faqe 5) është mirë të na sqarohen shumtë e paguara për vendime gjyqësore nga mallrat dhe shërbimet 5,844.08 € dhe shpenzime kapitale për vendime gjyqësore pagesa 119,753.34 € që gjithsej janë pagesa 125,597.42€ për çfarë vendimi gjyqësor është fjala. Faqe 7 shpenzimet për mallra dhe shërbime, shpenzime komunale dhe subvencione, shpenzime për telefoni mobile kemi afër 7000€ më shumë se vitin paraprak, karburante për vetura afër 10000€ më shumë se viti paraprak dreka darka në raport me vitin paraprak mbi 16000€ (2017 janë shpenzuar 29,881.24€ - 2016 janë shpenzuar 13,711.23€) është e tepërt në vend të zvogëlimit janë rrit dyfish e më shumë. Faqe 23 Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes, përveç periudhës raportuese siç e ceka më lart 01.01.2017 -13.03.2018 tabela është e pakuptueshme andaj kërkoi sqarim, thuhet të pranuar a është fjala për kërkesa apo çka. Nëse është fjala për kërkesa të pranuar në kolonën pranuar duhet të figurojnë të gjitha kërkesat e parashtruara nëpër departamente e pastaj të paraqitet statusi i tyre në kolonat tjera dhe totali prapë të japë kolonën e parë kjo është e pakuptueshme, kërkojmë sqarim. Faqe 47 te taksa për leje ndërtimore 61 leje, kemi 654,758.31 €, kurse te faqja 3 te të hyrat vetanake sipas drejtorive kjo shifër nuk ekziston askund, po në faqen 47 të hyrat nga shfrytëzimi i pronës publike kemi 26,134.51€ e në faqen 3 të hyrat nga kjo kategori kemi 30,971.38 € cila është e saktë.

Lutfi Gërgurri, drejtor i DBF-së-paraqiti sqarime lidhur me Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2017, duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës - iu sugjeroi anëtarëve të kuvendit që të përmbahen nga dikursi i diskutimeve politike, pasi që kemi të bëjmë me një raport të një kryetari të cilit i ka përfunduar mandati, në ndërkohë që tani PDK dega në Vushtrri tani është në opozitë kjo bëhet e qartë se ata e kanë marrë përgjigjen nga qytetarët e Komunës së Vushtrrisë.

Sami Istrefi, anëtar i kuvendit - tha se pajtohet me parafolësin e tij, dhe shtoi se raporti duhet t'i nënshtrohet një korrigjim qoftë në aspektin gjuhësor, por edhe në kuptimin e përmirësimit të shifrave financiare. Pastaj vlerësoi se kur bëhet fjalë për shpenzimet komunale, ai arsyetoi se nëse merret për bazë realizimi i projekteve në territorin e komunës, atëherë është e domosdoshme që këtë shpenzime të bëhen. Tutje ceku se kryetari i cili tani ka përfunduar mandatin e tij ka qenë jashtëzakonisht i kujdesshëm në shpenzimin e parasë publike dhe këtë e dëshmon fakti se kartelën personale nuk e ka shfrytëzuar asnjëherë. Në anën tjetër duhet të merret për bazë fakti se sa shumë projekte janë realizuar gjatë qeverisjes së kaluar, ku kjo dëshmon se kur PDK ka marrë mandatin buxheti i komunës ka qenë 900.000 €, ndërsa ku qeverisja e saj ka përfunduar buxheti ka vlerën mbi 17.000.000 € dhe kjo duhet të vlerësohet pozitivisht.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit - duke iu referuar raportit, ceku se në fushën e arsimit është karakteristike se kemi rënie të përqindjes sa i përket testit të kalueshmërisë në nivelin lokal për vitet 2015,2016, dhe 2017, derisa në vitin 2015 kemi kalueshmërinë prej 52.93 %, në vitin 2016 kemi 52.27 % kurse në vitin 2017 46.93%, kjo i bie se kemi një rënie të vazhdueshme nga viti në vit, andaj për këtë a është bërë ndonjë analizë nga DA-ja se përse kemi këtë rënie, dhe cilët do të jenë hapat që do të ndërmerren që kjo kalueshmëri të përmirësohet. Nga tabela e suksesit të nxënësve për vitin 2016/2017 është dhënë numri i nxënësve nga klasa I-IX për të gjitha shkollat fillore dhe ato të mesme të ulëta, si dhe për tri shkollat e mesme të larta, mirëpo në tabelë nuk është dhënë numri i mësimitdhënësve dhe punëtorëve nëpër shkolla andaj, si grup kuvendar i LVV-së kërkojnë nga DA-ja që në raportet e ardhshme në formë tabelare të paraqiten edhe numri i punëtorëve dhe mësimitdhënësve nëpër secilën shkollë si dhe klasifikimi i tyre mendon se është në interes të anëtarëve të kuvendit dhe qytetarëve të Vushtrrisë të dinë se cili është kualifikimi i mësimitdhënësve dhe të dihet se kush jep mësim në shkollat tona. Tek regjistrimi i nxënësve në klasat e X (dhjeta) për vitin 2017/2018 në shkollat e mesme të larta shihet që në tri shkollat e mesme janë regjistruar nga 14 klasë në shkollën profesionale “Bahri Haxha” 420 nxënës në (14 klasë), në shkollën e mesme teknike “Lutfi Musiqi” janë regjistruar 320 nxënës në (14 klasë) dhe në shkollën e mesme gjimnazi “Eqrem Çabej” janë regjistruar 392 nxënës gjithashtu në (14 klasë) dhe në këtë rast shihet se kemi dallim mes shkollës teknike dhe asaj profesionale sa i përket regjistrimit të nxënësve në klasën e X (dhjetë). Pastaj tek aktivitetet kryesore të Drejtorisë së Arsimit thuhet që vazhdimisht ekipi kundër braktisjes në bashkëpunim me QPS-në për parandalimin dhe zvogëlimin e kësaj dukurie, mirëpo këtu nuk është evidentuar numri i nxënësve që kanë braktisur shkollën në vitin shkollor 2016/2017. Në faqen 32 të informatës tek trajnimet e mësimitdhënësve në një fjali thuhet: KQZ mbajti trajnim për zgjedhjet parlamentare dhe komunale, për këtë shtroi pyetjen se çfarë ndikimi ka pasur ky trajnim në procesin e mësimitdhënies dhe mësimitnxënies apo në ngritjen e cilësisë së arsimit ose në të kundërtën kjo ka ndikuar në politizim të shkollave. Në shkollën e mesme profesionale “Bahri Haxha” por edhe në shkollën teknike organizohet mësimi për të rritur, por në këtë raport për këtë gjë nuk është shkruar asnjë fjali e vetme, mendon që kjo është me interes që kjo të përfshihet në raportet e ardhshme. Në raportin e punës nuk është përfshirë as organizimi i shëtitjeve ekskursioneve dhe mbrëmjet e maturës, dhe edhe kjo në raportet e ardhshme duhet të përfshihet, për faktin se në këto organizime kemi shkelje të udhëzimeve administrative. Në fund përgëzoi profesorët e shkollës së mesme gjimnazi “Eqrem Çabej” prof. Hysen Ademin dhe prof. Safet Shalaku të cilët në basketboll në garat republikane kanë zënë vendin e parë, si dhe kanë përfaqësuar Kosovën në kampionatin botëror shkollor në Kroaci ku janë renditur në vendin e gjashtëmbëdhjetë në nivel botëror në sportin shkollor botëror.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - duke iu referuar faqes 13 të raportit, pyeti se projekti asfaltimi i rrugëve në fshatin Zhilivodë projekt dyvjeçar i cili është dashur të fillohet, por siç dihet ky projekt fare nuk ka filluar, porse nga praktika dimë që janë planifikuar shumë projekte dhe ato nuk kanë mundur të realizohen. Pastaj tek projekti ndërtimi i lapidarëve, konkretisht ai pyeti lidhur me ndërtimin e lapidarit për Batalionin e parë (I) të Brigadës 142 të UÇK-së, ku në raport ceket ndër të tjera realizmi Jo, ku nuk ka pasur zhvillim të procedurave të prokurimit, për shkak të planifikimit të pamjaftueshëm të mjeteve financiare. Si përfundim ai vlerësoi se në realizimin e këtij projekti ka pasur zvarritje andaj kërkoj që ky projekt të përfundohet sa më parë.

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës - tha se lapidari për Batalionin e parë (I) të Brigadës 142 të UÇK-së, do të ndërtohet dhe ai do të qëndrojë bashkëkrenar në atë pjesë ashtu siç e meriton.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - tha se në mandatin e kaluar kuvendi e kishte mbështetur financiarisht hartimin e një monografie për Batalionin e IV të Brigadës 141 “Mehë Uka” ZOSH-së. Tutje shtoi se kishte me qenë shumë ma mirë që ky lapidar të bëhet për të dy Batalionet të Brigadës 142 të UÇK-së.

Sami Istrefi, anëtar i kuvendit - tha se vullnetit i qeverisë së kaluar ka qenë që të përfundohej projekti për lapidarin, por vështirësitë janë paraqitur kur është vendosur të caktohet lokacioni i këtij lapidari, por ky projekt gjendet në zhvillim dhe besojmë që gjatë këtij viti ky projekt do të finalizohet.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - tha se nuk është mirë që të tentohet në forma të ndryshme që mjetet financiare të dedikuara për lapidarin e UÇK-së, të barten në ndonjë projekt tjetër dhe atë mbi baza politike, sepse qytetarët e asaj zone janë të njoftuar për këtë projekt, andaj ata presin që ky projekt të përfundohej sa më parë.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - apeloj që të jemi të kujdesshëm, si në vendosjen e lapidarëve, ashtu edhe në shkrimin e historisë sonë, me qëllim që mos të na përsëriten gabime ashtu siç ka ndodhur në të kaluarën. Për këtë ai vlerësoi se historia duhet të shkruhet nga historianët e mirëfilltë e jo nga publicistët, si dhe historia duhet t'i shkruhet optikës shkencore dhe vërtetimit të saj me metoda shkencore.

4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim me kompensim të vendgjuetive të përbashkëta

Sami Istrefi, anëtar i kuvendit - tha se lidhur me këtë çështje ekziston një vendim i mëhershëm dhe ai është i njëjtë me këtë që është proceduar sot, andaj vlerësoi se për këtë çështje nuk ka nevojë të votohet sepse vendimi ekziston.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se nuk e di se sa është konsultuar ligji lidhur me këtë çështje pasi që pronat, të cilat do të jepen në shfrytëzim, disa gjenden në pronësi shoqërore e disa në pronësi private dhe kjo mund të shkaktojë probleme pronarëve privat, dhe në këtë rast ekziston mundësia që komuna të marrë ankesa dhe të penalizohet për shkak të dëmeve që mund t'u shkaktohen pronarëve të pronave private.

Miran Halili, drejtor i DBPZHR-së - paraqiti sqarime lidhur me propozim-vendimin duke iu dhënë përgjigje në temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

Idriz Muzaqi, udhëheqës i zyrës ligjore -tha se sa i përket kësaj çështjeje duhet sqaruar se vendimi i marrë në vitin 2009 është vendim për themelimin e vendgjuetive, kurse tani kuvendi ka para vetes një propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim me kompensim të vendgjuetive të përbashkëta, e që i bie se kemi të bëjmë me dy vendime të ndryshme. Tutje shtoi se në aspektin legal nuk ka kurrfarë pengese ligjore që ky propozim të aprovohet, pasi që dhënia në shfrytëzim e këtyre vendgjuetive nuk nënkupton që operatori ekonomik do të bëjë çfarë ai dëshiron, por gjithçka do të vendoset konform rregullativës juridike.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim me kompensim e vendgjuetive të përbashkëta e konstatuar nga organet gjegjëse, në bazë të sipërfaqeve të përgjithshme të vendgjuetive të cekura si më poshtë:

1.1. Shalë.....20.695,09 ha

1.2. Çyqavica.....13.785,34 ha

2. Dhënia në shfrytëzimin e vendgjuetive të cekura në pikën 1 të këtij propozim vendimi bëhet nëpërmes shpalljes publike-ankandit. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky propozim vendim do të rregullohen me kontratë të veçantë konform dispozitave ligjore në fuqi.

3. Afati i dhënies në shfrytëzim të vendgjueve është 10 vite.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtorja për Prokurim dhe Drejtorja për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

5. Shqyrtimi i Draft-rregullores për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione personave juridikë-OJQ dhe ndihmë momentale personave fizikë (shqyrtimi i parë)

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Përcaktimin e Kriterëve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë.

2. Diskutimi publik fillon nga data 06 prill 2018 dhe zgjat deri më 07 maj 2018.

3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmarrë masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

4. Obligohen Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesja Sociale dhe Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport që si propozues të draft-rregullores në fjalë të organizojë diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2015 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013. Gjithashtu obligohen drejtoritë e sipërcekura që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantojnë Kuvendit të Komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë në mbledhjen e kuvendit në muajin maj 2018.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

6. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të objekteve

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës pa kompensim për Ministrinë e Punëve të Brendshme-Akademisë së Kosovës për Siguri Publike;

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit - pyeti se prona në të cilën ndodhet gjykata, a është kthyer në pronësi të komunës pasi që kjo ka qenë e paraparë me vendimin e marrë ma herët kur është vendosur që t’i jepet në shfrytëzim prona Ministrisë së Punëve të Brendshme-gjegjësisht Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës - njoftoi kuvendin se në kuadër të takimit që ka zhvilluar me Kryeministrin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ka marrë zotimin nga ana e tij se të

gjitha pronat që janë nën menaxhimin e AKP-së në qytetin tonë, në saje të një kërkesë të parashtruar Qeverisë së Kosovës do të kthehen në pronësi të komunës për nevojat e kësaj të fundit. Tutje vlerësoi se sa i përket pronës të ish-vicianumit, për këtë është bërë kërkesa për kthimin e pronësisë në komunë dhe presim që kjo të realizohet ditëve në vijim. Në këtë kontekst njoftoi se kërkesa për kthimin e pronave do të bëhet edhe për disa prona tjera në lokacionin afër kompanisë “Uniteti”, për faktin se komuna është duke hulumtuar që të gjejë një lokacion të përshtatshëm për vendosjen e stacionit të autobusëve.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim jepet në shfrytëzim pa kompensim pjesë nga parcela P-70202016-02358-1, ZK-Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë, në sipërfaqe prej 4000 m², nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës prej 45655m².

2. Paluajtshmëria e cekur në nenin 1 të këtij vendimi i jepet në shfrytëzimin pa kompensim, në afat prej 99 vitesh, Ministrisë të Punëve të Brendshme – Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, për ndërtimin e objektit të Fakultetit për Shkenca të Sigurisë Publike.

3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

4.Pjesë përbërëse e këtij vendimi është certifikata e pronës dhe kopja e planit.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

8.Shqyrtimi i Informatës lidhur me Punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2017

9.Shqyrtimi i Propozim-vendimit për korrigjimin e vendimit të kuvendit të komunës Nr.52/18 i 22.02.2018

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së - paraqiti sqarime hyrëse lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke shtuar se parcelës kadastrale me numër P- 263- Zona Kadastrale Hercegovë duhet t’i shtohet shkronja K, e cila tregon që kjo parcelë ndodhet nën masën e komasacionit.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim korrigjohet vendimi nr.52/18 i datës 22/02/2018 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme pika një (1), paragrafi një (1.1) dhe dy (2) i këtij vendimi.

2. Pika 1, paragrafi 1 dhe 2 i vendimit korrigjohen me sa vijon:

2.1. Parcela Kadastrale 00557-0 duhet të jetë Parcela Kadastrale 00557-1;

2.2. Parcela Kadastrale 263, Zona Kadastrale Pantinë duhet të jetë P- 263-K Zona Kadastrale Hercegovë.

3. Pjesët tjera të vendimit mbesin të pandryshuara.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

10. Të ndryshme.

a). Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë lidhur me themelimin e Komitetit për Komunitete.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - njoftoi se grupi kuvendar i PDK-së ka dërguar kërkesë në ministrinë gjegjëse për interpretimin e kësaj çështjeje, por për këtë çështje akoma nuk është dhënë përgjigjja, ndërsa kërkesa për interpretim është bërë për Komitetin për Komunitete dhe Komitetin për Politikë dhe Financa. Në fund tha se si grup nuk do të marrin pjesë në këto komitete derisa të jepet përgjigjja për këtë çështje.

Idriz Muzaqi, udhëheqës i zyrës ligjore - tha se vendimi i kuvendit për themelimin e Komitetit për Komunitete është i ligjshëm dhe i plotfuqishëm, ndërsa e drejta për të propozuar emrat nga ana e grupit kuvendar të PDK-së është çështje politike.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit - pasi falënderoi grupin kuvendar të PDK-së për debatet e tyre me argumente adresuar në çështjet e rendit të ditës, kërkoi nga shefi i grupit të PDK-së që ta propozojë emrin për anëtar të Komitetit për Komunitete, ndërsa shtoi se nëse ministria gjegjëse vlerëson se PDK-së i takojnë dy anëtarë në Komitetin për Komunitete, atëherë ky vendim do të mund të plotësohet. Lidhur me deklarin e anëtares së kuvendit znj. Mejreme Ismajli, ceku se grupi i PDK-së është e vërtetë që po dëmtohet për një anëtar po në këtë rast po pasurohet sharmi i demokracisë dhe kështu edhe do të mbrohet interesi i qytetarëve prej çdo pozicioni politikë. Në fund ai luti që të propozohet emri për anëtar të Komitetit për Komunitete, ose në të kundërtën ai do ta propozojë një anëtar nga radhët e partive tjera politike.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se me keqardhje potencon se këtë situatë e ka krijuar kryesuesi i kuvendit, kjo për faktin se grupi kuvendar i PDK-së që në mbledhjen e parë të KK-së ka kërkuar që kryesuesi të kërkojë interpretim ligjor në ministrinë gjegjëse lidhur me këtë çështje. Tutje ai insistoi se grupit kuvendar të PDK-së i takojnë tre anëtarë në KPF dhe dy anëtarë në Komitetin për Komunitete. Në fund ai deklaroi se anëtari i KK-së z. Qerim Selimi nuk ka mandat të propozojë emra në emër të grupit kuvendar të PDK për këtë komitet, por ai mund të bëjë propozime individuale.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit - tha se nuk është mirë që të tregohemi të ngurtë, por duhet të japim propozime që ofrojnë zgjidhje dhe jo t'i bllokojmë proceset. Tutje ai shtoi se është anëtar i PDK-së dhe se nuk e ka ndërmend të jap dorëheqje nga kjo parti, por nëse dikush në kundërshtim me vlerat dëshiron të imponojë çështje për interesa individuale, atëherë ai këtë nuk do ta lejojë dhe nuk do të pranojë kurrë. Në fund përsëriti që duhet të propozohet emri për anëtar të Komitetit për Komunitete.

Melihate Basholli-Latifi - fillimisht paraqiti vërejtje tek kryesuesi i kuvendit për siç tha se kërkesën për interpretim nuk e ka bërë sipas asaj që është dashur, por atë e ka bërë ashtu siç ka dashur vet. Pastaj vlerësoi se grupit kuvendar të PDK-së i takojnë dy anëtarë në Komitetin për

Komunitete dhe në emër të grupit propozoi Habibe Gërxhaliun dhe Fatmire Saraçin për anëtare të Komitetit për Komunitete.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kryesuesi i kuvendit i hodhi në votim dy propozimet dhe në këtë rast anëtarja e kuvendit Habibe Gërxhaliu mori 1 votë, kurse Fatmire Saraçi anëtare e kuvendit mori 19 vota andaj në këtë rast kuvendi vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim plotësohet vendimi i Kuvendit të Komunës me Nr. 56/18 i datës 22.02.2018 lidhur me emërimin e anëtarëve të Komitetit për Komunitete të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, kështu që znj. Fatmire Saraçi nga radhët e PDK-së emërohet anëtare e Komitetit për Komunitete.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

b).Shqyrtimi Propozim-vendimit për Ndryshimin e Vendimit me Nr.50/18 i datës 22.02.2018 për Bartjen e të Hyrave Vetanake nga viti 2017 në vitin 2018

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim bëhet ndryshimi i vendimit i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me Nr.50/18 i datës 22.02.2018 për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2017 në vitin 2018 në kategoritë si në vijim:

1.1 Paga dhe mëditje	1,253.99 €
1.2 Mallra dhe shërbime	91,427.70 €
1.3 Shpenzime komunale.....	4,828.97 €
1.4 Subvencione dhe transfere.....	166.00 €
1.5 Investime kapitale	893,284.26 €
Totali i mjeteve të bartura	990,960.92 €

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

3.Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operacionale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

c). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:

Sami Istrefi, anëtar i kuvendit - në emër të grupit kuvendar të PDK-së tha se e mbështetësin kërkesën për ofrimin e ndihmës financiare për hartimin e monografisë nga profesori Ferit Dibrani.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - përsëriti shqetësimin e tij për gjendjen e rëndë të dy fshatrave Pasomë dhe Tërlllobuq, si pasojë e eksploatimit të një guri shkëmbor nga ana e dy operatorëve ekonomikë, në ç'rast kur temperaturat janë të larta pluhuri shkon deri në 100 metra lartësi dhe kështu shkaktohen shumë dëme. Tutje shtoi se nga qeveria e kaluar kishte pasur premtime, se rruga në gjatësi prej 800 metrave në drejtim të lagjes "Dautaj" në fshatin Pasomë do të ndërtohet, por ky projekt akoma nuk ka filluar dhe se në dokumentacion zyrtar nuk e ka hasur se ekziston apo është planifikuar ndërtimi i asaj rruge. Andaj kërkoi nga organet komunale që ky projekt të jetësohet. Ndërsa lidhur me fushën në fshatin Pasomë e cila është përfshirë nga mbeturinat e sidomos nga mbeturinat nga materiali ndërtimor, kërkoi nga komuna që të kontrakttojë ndonjë operator ekonomik për pastrimin e asaj fushe.


Agron Perçuku, anëtar i kuvendit - pyeti se sa janë borxhet e tatimit në pronë të qytetarëve për vitet paraprake para vitit 2018, dhe se nëse këto borxhe kalojnë shumën prej 100 €, të bëhen publike dhe të ofrohen para kuvendit që ato të diskutohen si material në kuvendin e komunës. Pastaj pyeti Drejtorinë e Urbanizmit se ka raste të lëshimit të lejeve ndërtimore ku pagesa do mund të bëhej me rata dhe nëse ka sa është borxhi nga këto leje ndërtimore. Mandej ai adresoi pyetje Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ku ceku se në Rr. "Isa Boletini" një shtëpi e një pjesëtari të komunitetit rom është shembur tash e disa vite dhe asgjë deri më sot nuk është ndërmarrë, edhe pse shembja e kësaj shtëpie po shkakton pengesa në rrugë. Mandej në rrugën "Qemajl Shaqiri" është një vrimë e hapur nga KEDSI, për shkak të një problemi në rrjetin energjetik, dhe kjo gropë është akoma e hapur, ndërsa në rrugën "2 Korriku" është një gropë e hapur nga Kompania e Ujësjellësit, për shkak të problemeve me rrjetin e ujësjellësit dhe kjo po ndodh tash e disa vite, dhe askush nuk ka ndërmarrë kurrfarë veprimesh për rregullimin e këtij problemi.

Sami Istrefi, anëtar i kuvendit - tha se në lagjen "Dautaj" në fshatin Pasomë, ekziston një gjendje jo e mirë, dhe shtoi se në kuadër të kontakteve që kanë pasur me kompaninë që është duke e shfrytëzuar gurin shkëmbor, fjala është për Kompaninë "Beni com" e cila ka shprehur gatishmëri që të lidh marrëveshje me komunën që të gjitha shtresat e rrugës deri në asfaltim t'i mbulojë kompania e tij, kurse asfaltimin mbetet që ta bëjë komuna.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - duke u përgjigjur në pyetjen e anëtarit të kuvendit z. Ali Januzi, njoftoi se komuna ka filluar të bisedojë me operatorin ekonomik që është shfrytëzues i gurit shkëmbor në fshatin Pasomë, ku operatori ekonomik ka shprehur gatishmërinë që të bëjë një pjesë të investimit dhe shpreson që ky projekt të përmbillet sa më shpejt. Ndërsa sa i përket deponisë së mbeturinave në fshatin Pasomë njoftoi se ka zhvilluar biseda me KFOR-in që ata në bashkëpunim me FSK-në ta heqin atë deponi e cila është duke u përhapur gjithandej në atë pjesë.

Mbledhja përfundoi në ora 12:55.


Bastri Duraku



Procesmbajtës



Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit